



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

URDHËR

NR. 150, datë **6**, **2**. 2018

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE PËR VENDBURIMET EKZISTUESE “CAKRAN-MOLLAJ”,
“GORISHT-KOCUL” DHE “AMONICË”.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit Nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, VKM nr. 335, datë 22.04.2015 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 279, datë 12.04.2012, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol” Sh.a)” dhe për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit, zhvillimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për vendburimet ekzistuese, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

1. Njoftimin për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrje me anën e aplikimeve, për të lidhur marrëveshje hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet ekzistuese “Cakran-Mollaj”, “Gorisht-Kocul” dhe “Amonicë”.
2. Albpetrol Sh.a. të publikojë menjëherë në faqen e saj të internetit hartën për vendburimet ekzistuese “Cakran-Mollaj”, “Gorisht-Kocul” dhe “Amonicë” si dhe formularin e aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit, nga subjektet e interesuara, për të lidhur marrëveshje hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Cakran-Mollaj”, “Gorisht-Kocul” dhe “Amonicë” i cili duhet të jetë deri më datën 31.03.2018.
3. Dokumentacioni që do të publikohet të dërgohet në mënyrë zyrtare në MIE dhe një kopje e tij të dërgohet në adresën elektronike të saj. MIE të publikojë në faqen e saj të internetit këtë dokumentacion.

4. Në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të “Rregullores për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, e ndryshuar, në Albpetrol Sh.a. të ngrihet grupi negociator për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjeve Hidrokarbure, të mundshme, për t’u lidhur. Përfaqësues i MIE në këtë grup, do të jete z. Ilia Gjermani.
5. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Albpetrol Sh.a., si dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

